



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 733 Prot.

Tiranë, më 07.07.2021

URDHËR

Nr. 49, datë 07.07.2021

“Për verifikimin e rasteve të emërimit në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Sarandë dhe Bashkinë Finiq”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas informacioneve të administruara në lidhje me plotësimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil, duke mos respektuar procedurën e konkurrimit, Komisioneri vlerëson se lindin dyshime të arsyeshme për parregullsi në zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Sarandë dhe në Bashkinë Finiq.

P e r k e t e a r s y e

URDHËROJ:

1. Nisjen e inspektimit për verifikimin e informacionit në lidhje me plotësimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin në Bashkinë Sarandë dhe në Bashkinë Finiq.
2. Verifikimi të kryhet në subjekt nga data **12.07.2021** deri në datën **16.07.2021**, nga grupi i inspektimit i përbërë nga Drejtori i Drejtori i Përgjithshëm Arbana Basha dhe inspektorët Alda Xhaxhiu, Aida Dobjani dhe Behare Hoxha.
3. Relacioni i përgatitur, i shoqëruar me aktet e administruara në subjekt, duhet t’i paraqiten Komisionerit për të vijuar më tej me procesin e rregullimit të situatës.
4. Grupi do të përdori transportin publik për të realizuar transportin për në subjekt.

5. Të merren masat për njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet inspektimit, në përputhje me nenin 42, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*".

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha